



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË FERIZAJT PËR VITIN 2024

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Ferizajt për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Ferizajt (K.F), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Ferizajt, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Obligimet e papaguara të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare ishin nënvlerësuar për 1,711,063€.
- B2 Vlera e detyrimeve kontigjente të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare ishte mbivlerësuar për 895,712€.
- B3 Shpenzime në vlerë 689,827€ janë regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate.
- B4 Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare shin mbivlerësuar për 143,870€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Në kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Ferizajt kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B5 Në 62 raste në vlerë 4,749,589€, pagesat e faturave ishin vonuar përtej afatit ligjor prej 30 ditësh;
- B6 Pesë (5) pagesa për investime kapitale në vlerë totale 167,659€, janë paguar nga buxheti i projekteve kapitale jo përkatëse;
- A1 Në tri (3) aneks kontrata në vlerë 75,085€, mungonin garancionet e kualitetit të punimeve për punët shtesë të realizuara;
- A2 Në tri (3) raste, kishte vonesa në shqyrtimin e lejeve ndërtimore pas afatit të lejuar prej 45 ditësh;
- A3 Në dy (2) raste ishte bërë subvencionimi i OJQ-së dhe fermerëve jo në pajtim me kriteret e thirrjes publike.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Ferizajt.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Ferizajt është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Ferizajt në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Ferizajt me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Ferizajt.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Kontrollet e brendshme gjatë procesit të raportimit financiar duhet të avancohen. Përmirësimet janë të nevojshme gjatë përgatitjes së pasqyrave vjetore financiare dhe shpalosjeve të shënimeve shpjeguese për detyrimet kontigjente, obligimeve të papaguara dhe llogarive të arkëtueshme. Në aspektin e pajtueshmërisë, përmirësime janë të nevojshme në regjistrimin e pagesave në kategoritë përkatëse, menaxhimin e duhur dhe realizimin me kohë të kontratave publike, pagesën brenda afateve të obligimeve ndaj kontraktuesve, proceset e subvencionimit dhe menaxhimit të pasurisë me qëllim funksionalizimin e sistemit e-pasuria.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre 10 janë rekomandime të përsëritura dhe 3 rekomandime të reja,

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Nënvlërësim i vlerës së obligimeve të papaguara në pasqyrën vjetore financiare

Gjetja

Rregullorja MF. nr. 01/2017, neni 17, përcakton që OB-të të raportojnë të gjitha detyrimet e papaguara të vitit raportues.

Obligimi financiar ndërlidhur me propozimin për përmbarim nga vendimi gjyqësor për shpronësimin e tokës në vlerë 1,711,063€, ishte raportuar fillimisht në pasqyrat vjetore financiare që komuna kishte dorëzuar në Thesar. Pas dorëzimit të pasqyrave, komuna ka pranuar nga Thesari një shkresë, përmes së cilës komuna informohet se përmbaruesi privat ka konfirmuar tërheqjen e kësaj lënde. Me korrigjimin e pasqyrave vjetore financiare, kjo lëndë nuk është shpalosur, ndonëse e njëjta vazhdon të jetë obligim financiar, por e tërhequr për një kohë nga procesi i pagesës përmes përmbarimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të keqkuptimit nga ana e komunës për obligimin që ka ndaj debitorit, dhe pakujdesisë në përditësimin e regjistrit të obligimeve të papaguara në pasqyrat vjetore financiare.

Ndikimi

Mos përfshirja e plotë e obligimeve në regjistrin përkatës ka rezultuar me nënvlerësim të obligimeve dhe prezantim të pasaktë të informacionit në pasqyrat vjetore financiare.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës të financave analizojnë si duhet, mbajnë evidenca të sakta dhe të plota për detyrimet e papaguara, dhe se vlera e tyre të jetë e saktë në pasqyrat vjetore financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B2 - Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente në pasqyrat vjetore financiare**

Gjetja Rregullorja MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga OB-të, neni 6, përcakton që OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Vlera e detyrimeve kontigjente në pasqyrat vjetore financiare ishte mbivlerësuar për 895,712€, për shkak se në regjistër ishin evidentuar vlera të gabuara, ishin përfshirë padi të tërhequra dhe pretendime për të cilat kishin përfunduar procedurat gjyqësore dhe ishin marrë vendimet përfundimtare nga gjykata.

Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë në përditësimin e informatave në regjistrin e kontigjencave dhe prezantimin financiar, si dhe mungesës së personelit të mjaftueshëm në administrimin e lëndëve gjyqësore.

Ndikimi Mos azhurnimi me kohë i regjistrit të detyrimeve kontigjente ka ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve kontigjente dhe prezantimin jo të saktë të tyre në pasqyrat vjetore financiare.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e kontrolleve të duhura në azhurnimin me kohë të raportit të detyrimeve kontigjente, dhe se prezantimi i tyre në pasqyrat vjetore financiare të jetë i plotë dhe i drejtë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate**

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës Financiare nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Gjithashtu, me planin kontabël të SIMFK-së janë përcaktuar saktë kategoritë ekonomike të shpenzimeve dhe kodet përkatëse prej nga duhet të realizohen pagesat e shpenzimeve sipas secilit lloj.

Rezultatet e testeve identifikuan se pagesat në vlerë totale 689,827€ nuk janë klasifikuar në kategorinë e duhur ekonomike. Keq-klasifikimet kanë rezultuar te këto kategori ekonomike:

- Për shpenzime që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve, e që kanë të bëjnë pagesat për kontratën kolektive të punonjësve të arsimit, janë paguar 95,709€ nga buxheti i kategorisë së investimeve kapitale, 85,666€ nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve, dhe 14,310€ nga buxheti i subvencioneve;
- Për shpenzime që i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, janë paguar 104,630€ nga buxheti i investimeve kapitale;
- Për shpenzime që i takojnë subvencioneve, janë paguar 117,232€ nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve; dhe
- Për shpenzime që i takojnë investimeve kapitale, janë paguar 240,504€ nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve dhe 31,777€ nga

buxheti i subvencioneve.

Kjo ka ndodhur për shkak të pagesave nga Thesari si rezultat vendimeve gjyqësore të ndërlidhura me kontratën kolektive për punonjësit e arsimit, si dhe mangësive në planifikimet buxhetore.

Ndikimi

Regjistrimi i shpenzimeve nga buxheti i kategorive ekonomike jo adekuate pamundëson raportim të drejtë dhe të saktë të informacionit financiar të shpenzimeve në PVF. Shfrytëzimi i buxhetit të investimeve kapitale për pagesën e shpenzimeve që i takojnë kategorive ekonomike tjera, vështirëson realizimin me kohë dhe si duhet të projekteve kapitale.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime të nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit, dhe në rastet ku është e mundshme të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim që pagesat të regjistrohen në përputhje me planin kontabël të thesarit

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme në pasqyrat vjetore financiare

Gjetja

Rregullorja MF-Nr.01/2017 për Raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, neni 6 përcakton që, organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare ishin mbivlerësuar për 143,870€. Gabimet janë hasur në rastet si në vijim:

- Në një rast, në saldon e llogarive të arkëtueshme për lejet ndërtimore ishte përfshirë fatura e vitit 2025 në vlerë 496,531€, derisa nuk ishte përfshirë fatura e vitit 2024 në vlerë 331,021€, kurse në një rast tjetër kishte një nënvlerësim të llogarisë për 22,148€, për shkak të prezantimit jo të saktë të vlerës së papaguar të faturës; si dhe
- Në një rast, llogaritë e arkëtueshme për shfrytëzimin e pronës publike ishin mbivlerësuar për 507€, si pasojë e mos prezantimit të një fature të paguar.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos funksionit të duhur të kontrolleve të brendshme në mbajtjen dhe azhurnimin e regjistrave të llogarive të arkëtueshme nga drejtoritë përkatëse.

Ndikimi

Mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme ndikon në prezantim jo të saktë të informatave në pasqyrat vjetore financiare të komunës, dhe që palët e interesit apo shfrytëzuesit e pasqyrave vjetore financiare të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e tyre.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në drejtoritë përkatëse në mirëmbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme në mënyrë që të mundësohet prezantimi i saktë i tyre në pasqyrat vjetore financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B5 - Mos pagesa me kohë e obligimeve dhe kosto shtesë buxhetore për shkak të vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore

Gjetja

Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), neni 39.1 përcakton që ZKF i OB-së është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimi të faturës.

Në 62 raste në vlerë 4,749,589€, faturat nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditësh nga data e pranimi. Vonesat ishin nga 10 ditë deri në 6 vite.

Gjithashtu, sipas regjistrimit të siguruar nga Komuna, gjatë vitit 2024, si rezultat i procedurave përmbarimore dhe vendimeve gjyqësore për mos pagesën me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, si dhe obligimeve nga kontrata kolektive për personelin arsimor, në emër të kamatave, tarifave të përmbarimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore, janë paguar kosto shtesë në vlerë 436,423€.

Kjo ka ndodhur për shkak të menaxhimit jo të duhur të obligimeve, si dhe shpenzimit të buxhetit nga pagesat e vendimeve gjyqësore të ndërlidhura me zbatimin e kontratës kolektive.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e pagesave brenda afatit kohor, kanë ndikuar që komuna të jetë subjekt i padive nga kontraktuesit, duke shkaktuar kosto shtesë financiare për shkak të procedurave gjyqësore dhe përmbarimore.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e obligimeve dhe të siguroj se detyrimet ndaj kontraktuesve paguhen brenda afateve kohore, duke shmangur në këtë mënyrë kostot shtesë për shkak të procedurave gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Pagesa për investime kapitale nga buxheti i projekteve kapitale jo përkatëse

Gjetja

Ligji Nr. 08-L-260 për ndarjet buxhetore për vitin 2024, neni 16, pika 11, përcakton që, ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal.

Në pesë (5)^e pagesa për investime kapitale në vlerë totale 167,659€, janë shfrytëzuar fondet e projekteve tjera të aprovuara me ligjin e buxhetit. Mjetet janë shfrytëzuar për investimet e bëra në infrastrukturën rrugore, ndërtimin e kolektorit, objekt shkollor, parkun dhe rrjetin e ndriqimit publik. Këto ndryshime nga njëri projekt kapital tek tjetri ishin bërë pa ridestinin paraprak të mjeteve nga Kuvendi Komunal.

Kjo kishte ndodhur kryesisht nga mungesa e mjeteve buxhetore për projektet përkatëse, për shkak se nga fondi i projekteve përkatëse janë realizuar pagesa nga Thesari si rezultat i vendimeve gjyqësore për kontratën kolektive dhe konteste tjera.

Ndikimi Përdorimi i buxhetit të një projekti për pagesën e shpenzimeve të projektit tjetër redukton transparencën dhe pamundëson prezantimin e drejtë për projektet e realizuara. Gjithashtu, kjo mund të rrezikojë realizimin e atyre projekteve prej nga janë marrë mjetet, nëse gjatë vitit nuk sigurohen mjetet e mëvonshme dhe të mjaftueshme buxhetore për ato projekte.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë se pagesat për investimet kapitale bëhen nga fondi buxhetor i projektit përkatës. Në rastet e nevojshme dhe kur krijohen mundësit për ridestinin buxhetor, rialokimi i mjeteve të bëhet në pajtim me ligjin mbi ndarjet buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A1 - Mos përfshirja e punëve shtesë në vlerat e garancioneve të kualitetit të punimeve

Gjetja Në kushtet e veçanta të kontratave publike ishte përcaktuar vlera dhe periudha garantuese e defekteve pas përfundimit të kontratave përkatëse.

Pas përfundimit të tre (3) kontratave të punëve, garancionet e kualitetit të punimeve ishin bërë për vlerën e kontratave bazë, duke mos përfshirë edhe vlerën e punëve shtesë të realizuara me aneks kontrata. Rastet janë si në vijim:

- Aneks kontrata "Ndërtimi i sallës së sporteve dhe rregullimi i oborrit të shkollës Astrit Bytyqi ne Ferizaj", në vlerë 28,950€, mungonte garancioni i kualitetit të punimeve për punët shtesë në vlerë 2,895€;
- Aneks kontrata "Ndërtimi i kanalizimit dhe dislokimi i gypit të ujësjellësit në fshatin Surqinë", në vlerë 24,645€, mungonte garancioni i kualitetit të punimeve për punët shtesë në vlerë 2,464€; dhe
- Aneks kontrata "Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Tërre", në vlerë 21,490€, mungonte garancioni i kualitetit të punimeve për punët shtesë në vlerë 2,149€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve dhe monitorimit të pamjaftueshëm nga menaxherët e kontratave.

Ndikimi Mos ofrimi i garancionit bankar për kualitetin e punimeve në vlerën e duhur pamundëson kompensimin e dëmeve në rastet kur punët e kontraktuara nuk janë realizuar në kualitetin e duhur.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që në rastet kur kontratat publike përfundohen, pagesat përmbyllëse të kontratave të mos realizohen pa u siguruar paraprakisht garancioni bankar i kualitetit të punimeve edhe për vlerën e aneks kontratave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Vonesa në shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimore

Gjetja Ligji nr. 04/L-110 për Ndërtim, neni 17 pika 1.2, përcakton që “Leja Ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III”.

Në pesë (5) raste të lejeve ndërtimore që i takojnë kategorisë II, kërkesat për leje ndërtimore nuk ishin shqyrtuar brenda afatit kohor ligjor. Vonesat ishin nga 83 deri 494 ditë, pas afatit të lejuar prej 45 ditëve.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos funksionimit të mjaftueshëm të kontrolleve për të shqyrtuar kërkesat e lejeve ndërtimore në afatet e përcaktuara ligjore.

Ndikimi Shqyrtimi i kërkesave me vonesë ndikon në arkëtimin e vonuar të të hyrave nga lejet ndërtimore, si dhe në moskryerjen e shërbimeve me kohë ndaj aplikuesve.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme për shqyrtimin e kërkesave të lejeve ndërtimore në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Mangësi në proceset e subvencionimit për OJQ dhe fermer**

Gjetja Rregullorja MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, kërkon respektimin procedurave përmes plotësimit, nënshkrimit dhe dorëzimit të formularëve, përkatësisht formulari 13, Forma e deklaramentit të programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike. Në thirrjen publike të datës 25.03.2024 për mbështetjen financiare të OJQ-ve në komunën e Ferizajt, ishte kërkuar që aplikuesit të ofrojnë: Deklaratën e projekteve të financuara nga fondet publike në dy vitet e fundit (dokument i thirrjes publike), listën e aktiviteteve dhe projekteve të realizuara gjatë dy viteve të fundit (dokument i OJQ-së aplikuese), si dhe të integrojnë zhvillimin e auditimit të jashtëm të projektit në projekt-propozim (në vijat buxhetore të projektit të përfshihet edhe aktiviteti i auditimit të jashtëm). Gjithashtu, në thirrjen publike të datës 27.05.2024 për subvencionimin e fermerëve me mekanizëm bujqësor në Komunën e Ferizajt, një ndër kriteret ishte edhe kërkesa që fermeri duhet të ketë aplikuar për subvencione - pagesa direkte për vitin 2024, me përparësi fermerët që kanë të mbjellë sipërfaqe më të mëdha.

Nga auditimi i subvencioneve identifikua mangësitë në vijim:

- Subvencionimi i OJQ-së për projektin Fondacioni "Kosovarja Këndon", në vlerë 4,000€, përfituesi nuk kishte bashkangjitur në dosjen e aplikimit dokumentet siç kërkoheshin me thirrjen publike, formën e deklaratës së projekteve të financuara nga fondet publike në dy vitet e fundit, listën e aktiviteteve dhe projekteve të realizuara gjatë dy viteve të fundit, si dhe integrimin e zhvillimit të auditimit të jashtëm të projektit në vijat buxhetore të projekt-propozimit; si dhe

- Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor “Rota kosa 135”, në vlerë 1,320€, përfituesi i mekanizmit bujqësor nuk kishte ofruar dëshminë apo kopjen e aplikimit për subvencione - pagesa direkte për vitin 2024. Nga ana tjetër, tek ky subvencionim, një fermer ishte lënë në listën e mos përfituesve, ndonëse i njëjti kishte plotësuar të gjitha kriteret e thirrjes publike, për më tepër plotësonte edhe kriterin e përparësisë për fermerët që kanë të mbjella sipërfaqe më të mëdha.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të mangëta dhe mungesës së përgjegjësisë nga komisioni i vlerësimit për zbatimin e kriterëve të vendosura në thirrjet publike.

Ndikimi

Mos respektimi i kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike me rastin e subvencionimit rrezikon transparencën gjatë procesit dhe rezulton me përzgjedhjen jo të drejtë të përfituesve përkatësisht diskriminimin e aplikantëve që kanë plotësuar kriteret e thirrjes.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë se komisionet e vlerësimit të kërkesave për subvencionim u përmbahen kriterëve të vendosura në thirrjen publike, duke përzgjedhur vetëm aplikuesit që përmbushin në tërësi kriteret e përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 11,755,716€, dhe gjatë vitit 2024 ishte shpenzuar pothuajse i tërë buxheti. Investimet kapitale përbëhen nga investimet në infrastrukturën rrugore, nënkalim, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit, ndriçimit, makineri, furnizime me pajisje mjekësore, etj.

Çështja B7 - Vonesa në realizim të projekteve kapitale

Gjetja Sipas nenit 70.23 të Rregullës nr. 001-2022 për prokurimin publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave.

Testimet tona rezultuan me tre (3) projekte kapitale që nuk ishin realizuar në afatin kohor të përcaktuar me kontratë. Rastet janë të këto kontrata të punëve:

- Kontrata për “Ndërtimin e shkollës së mesme në Ferizaj” në vlerë 1,803,726€, duhej të përfundonte në fund të vitit 2019, derisa projekti ende nuk është realizuar në tërësi;
- Kontrata për “Ndërtimin e sallës së sporteve dhe rregullimi i oborrit të shkollës “Astrit Bytyqi” në Ferizaj në vlerë 296,988€, duhej të përfundonte në fund të vitit 2022, derisa ishte përfunduar në shtator 2023, apo me 9 muaj vonesë; dhe
- Kontrata për “Rregullimin e parqeve të vogla përmes konceptit Pocket Park” në vlerë 208,586€, duhej të përfundonte në fund të vitit 2024, derisa punimet ende nuk ishin përfunduar si tërësi.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme nga ana e menaxherëve të kontratave, kontesteve pronësore me AKP-në ku ishte planifikuar realizimi i projektit, por edhe mungesës buxhetore të ndodhura nga pagesat e realizuara nga fondi i investimeve kapitale për shkak të vendimeve gjyqësore.

Ndikimi Vonesat në realizimin e projekteve ndikojnë në mos arritjen e objektivave të komunës, dhe pamundësinë e shfrytëzimit të këtyre projekteve të cilat janë në shërbim të qytetarëve të komunës.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e kontratave në mënyrë që të sigurojë që kontratat publike realizohen sipas afateve kohore dhe kushteve kontraktuale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B8 - Mos përgatitja e planeve të menaxhimit të kontratave dhe mangësi në menaxhimin e kontratave

Gjetja

Neni 70, pika 10, e Rregullorës 001/2022 për prokurimin publik, përcakton që, pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i kontratës duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të kontratës. Si fazë e parë menaxheri i kontratës duhet do të përgatis dhe krijoj një plan për menaxhimin e kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi/mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlere të madhe, të mesme dhe të vogël.

Paragrafi 70,24.f. i Rregullores gjithashtu përcakton që, menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.

Derisa neni 70, pika 25 përcakton që, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për shqyrtimin, aprovimin dhe procedimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesve të plotësuar platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij/saj.

Gjithashtu, neni 54.15 sqaron se, kurdo që AK nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve/artikujve".

Rezultat e testimeve kanë identifikuar mangësi në menaxhimin e kontratave publike, kjo për shkak se:

- Në shtatë (7)⁸ kontrata publike, menaxherët e projekteve nuk kishin përgatitur planin për menaxhimin e kontratave, ndonëse pas nënshkrimit të kontratave, me vendim ishin caktuar menaxheret e projekteve dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të menaxherit, ku ishin caktuar detyrat dhe përgjegjësit e tyre;
- Në gjashtë (6) kontrata publike të përfunduara, menaxherët e projekteve dhe mbikëqyrësit e menaxherëve nuk kanë bërë vlerësimin e performancës së kontraktuesve në modulën e menaxhimit të kontratës në platformën e-Prokurimi. Gjithashtu, menaxherët e kontratave nuk kanë mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të e-Prokurimit menaxhimin e kontratave që ishin në proces të realizimit edhe në 10 raste të kategorisë e mallrave dhe shërbimeve; dhe
- Në projektin për furnizimin dhe ristrukturimin e rrjetit të ndriçimit publik në zonat I, II, III, IV, dhe në fshatrat Greme, Komogllavë, Rahovicë, Dardani, Sojevë dhe Kosinë, në vlerë 73,808€, menaxheri i kontratës, në situacionin e punimeve nuk kishte renditur pozicionet sipas formatit të paramasës dhe parallogarisë, për ti ndarë sipas përqindjes së secilit pozicion të punës, në mënyrë që të matej vlere të realizuar krahasuar me vlerën e planifikuar për pozicion.

Kjo kishte ndodhur për shkak të monitorimit të pamjaftueshëm nga ana e menaxherëve të kontratave, dhe mos zbatimit të kërkesave rregullative për përgatitjen e planeve për menaxhim të kontratave.

Ndikimi

Mos përgatitja e planeve për menaxhimin e kontratave dhe mos përditësimi i informatave rreth implementimit të projekteve në modulën elektronik pamundëson analizimin, përcjelljen dhe vlerësimin e performancës së realizimit të kontratave publike. Mos përgatitja e situacioneve të punimeve sipas formatit të paramasës vështirëson monitorimin dhe përcjelljen e realizimit të kontratës.

Rekomandimi B8

Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave përgatisin dhe nënshkruajnë së bashku me kontraktuesit planin e menaxhimit të kontratës, dhe se informatat rreth implementimit të projekteve azhurnohen me kohë në sistemin e-Prokurimi. Gjithashtu, menaxherët e kontratave të sigurojnë se situacionet e punëve të hartohen sipas formatit të paramasës dhe parallogarisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Në PVF të e vitit 2024, Komuna e Ferizajit ka shpalosur pasuritë kapitale në vlerë 245,411,472€, pasuritë jokapitale në vlerë 1,164,544€, dhe stoqe në vlerë 223,165€.

Çështja B9 - Mos përdorimi i sistemit elektronik për menaxhimin e pasurisë e-Pasuria

Gjetja

Me nenin 6, pika 3, e Rregullores MF - Nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, kërkohet që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-Pasuria.

Komuna nuk ka përdorur platformën elektronike e-Pasuria për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë jofinanciare nën 1,000€ dhe stoqeve. Në mungesë të përdorimit të këtij sistemi, komuna kishte regjistruar këto pasuri në një bazë të dhënave në formatin excel.

Kjo situatë ishte shkaktuar si rezultat i mungesës së veprimeve të nevojshme për funksionalizimin e sistemit e-Pasuria.

Ndikimi

Mirëmbajtja manuale e të dhënave rrit mundësinë e gabimeve në mirëmbajtjen e regjistrave, shlyerjeve potenciale, keqpërdorimit, humbjes apo të tjetërsimit tyre.

Rekomandimi B9

Kryetarit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura nga zyrtari i pasurisë dhe zyrtari i depos me qëllim funksionalizimin dhe regjistrimin e tërë pasurisë jokapitale dhe stokut në sistemin e-pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PFV e vitit 2024 në total janë 18,998,763€. Vlera e të arkëtueshmeve kryesisht përbëhet nga tatimi në pronë dhe tokë (75%), taksat për lejet ndërtimore (24%), dhe (1%) nga qiraja nga shfrytëzimi i pronave publike dhe participimet në çerdhen publike.

Çështja B10 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 27 përcakton që “Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori”.

Gjithashtu, në Vendimet për pagesë me këste për leje ndërtimore, pikat 6 dhe 7, përcaktojnë që nëse obligimet e parapara nuk përmbushen sipas afatit të përcaktuar me këtë vendim, do të ju anulohet vendimi për leje ndërtimore dhe objekti do të trajtohet si objekt pa leje ndërtimore.

Më tutje, sipas nenit 3 të Kontratës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, shfrytëzuesi obligohet që për shfrytëzimin e pronës afatshkurtër të paguaj shumën e cekur në kontratë deri më datën 05 të muajit rrjedhës.

Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2024 ishin gjithsej 18,998,763€, prej të cilave 14,312,847€ apo 75% ishin për tatimin në pronë. Komuna kishte dërguar letër rikujtim për detyrimet e papaguara ndaj disa debitorëve për përmbushjen e detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë, megjithatë nuk kishte pasur asnjë rezultat në arkëtimin e këtyre borxheve, marrë parasysh rritjen e borxheve të tatimit në pronë krahasuar me vitin paraprak. Në 46 raste të identifikuar komuna nuk kishte marrë masa shtesë, si ajo e veprimeve ligjore përmes përmbaruesit lidhur me mbledhjen e këtyre borxheve.

Gjithashtu, në dhjetë (10) raste të llogarive të arkëtueshme nga lejet ndërtimore në vlerë 972,287€, dhe në pesë (5) raste nga qiratë në dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në vlerë 70,819€, komuna nuk kishte ndërmarrë veprime ligjore për mbledhjen e këtyre borxheve, edhe pse ishte tejkaluar afati i përcaktuar në vendimin për pagesë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të vazhdueshme, përfshirë edhe ato ligjore, dhe hartimit të politikave nga ana e komunës për mbledhjen e të arkëtueshmeve.

Ndikimi

Mos arkëtimi me kohë i të arkëtueshmeve rezulton me të hyra buxhetore më të ulëta nga fondi i të hyrave vetanake. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të Komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

Rekomandimi B10

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga debitorët, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁹	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	41,184,014	43,034,889	42,966,383	45,328,253	36,730,534
Grante Qeveritare - Buxheti	35,774,287	36,182,045	36,148,784	35,744,461	28,081,163
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	235,608
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,374,919	1,369,215	1,927,084	2,174,905
Të hyrat vetanake	5,409,728	5,409,728	5,402,089	7,612,849	5,900,940
Donacionet vendore	0	15,008	0	788	44,047
Donacionet e jashtme	0	53,189	46,296	43,070	293,871

Buxheti përfundimtar është më i lartët se buxheti fillestar për 1,850,875€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të qeverisë në vlerë 407,758€, të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 1,374,919€, si dhe donacioneve në vlerë 68,197€.

Në vitin 2024 Komuna Ferizaj ka shpenzuar 99.8% të buxhetit përfundimtar ose 42,966,383€, pothuajse i njëjtë në krahasim me vitin paraprak, ku realizimi ishte 99.4%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	41,184,014	43,034,889	42,966,383	45,328,253	36,730,534
Pagat dhe mëditjet	20,332,804	20,761,696	20,758,916	20,572,860	16,339,440
Mallrat dhe shërbimet	8,000,000	8,032,097	7,997,874	9,322,932	6,686,492
Komunalitë	564,014	720,687	719,676	1,091,842	927,992
Subvencionet dhe transferet	950,000	1,764,692	1,761,211	1,525,404	1,493,631
Investimet Kapitale	11,337,196	11,755,716	11,728,706	12,815,214	11,282,980

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti për paga dhe mëditje është rritur për 428,892€. Rritja është ndikuar nga vendimet e qeverisë për mbulimin e mungesës buxhetore të shkaktuar nga pagesat e vendimeve gjyqësore në vlerën 407,758€, nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar në vlerë 10,232, si dhe 10,902€ nga donacionet. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit ishte 100%.
- Buxheti i mallrave dhe shërbimeve është rritur për 32,097€. Rritja është ndikuar nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar për 8,295€, dhe 23,802€ nga donacionet. Realizimi i buxhetit të kësaj kategori në fund të vitit ishte 99.6%.
- Buxheti final për shërbimet komunale është rritur për 156,673€. Kryesisht rritja është ndikuar nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar për 156,040€ dhe 633€ nga donacionet. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit ishte 99.9%.
- Buxheti për subvencione dhe transfere është rritur nga të hyrat e bartura të vitit të kaluar për 814,692€. Realizimi i buxhetit të kësaj kategori në fund të vitit ishte 99.8%.
- Buxheti për investime kapitale është rritur për 418,520€. Rritja është ndikuar nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar në shumë 385,660€ dhe 32,860€ nga donacionet. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 99.77%. Programi i Investimeve Publike përfshin 116 projekte kapitale të vitit aktual dhe viteve paraprake. Projektet kryesisht janë dedikuar për investimet në infrastrukturën rrugore, nënkalimit, ndriçimit, salla sportive, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit, lumenjve, makineri, furnizime me pajisje mjekësore, pajisje tjera, etj.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2024 ishin 6,194,484€, derisa ishin planifikuar 5,409,728€, duke tejkaluar planin për 784,756€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me të hyrat nga lejet ndërtimore, të hyrat nga tatimi në pronë, participimet, taksat për matjen e tokës, si dhe taksa tjera komunale. Në tejkalin e planit të të hyrave të vitit 2024 kanë ndikuar të hyrat nga lejet ndërtimore. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i inkasimit të të hyrave ka shënuar ulje prej 1,674,320€, që kryesisht i përket të hyrave tatimore, përkatësisht tatimit në pronë.

Në vitin 2024 Komuna ka përfituar 1,344,792€ të hyra nga gjobat në trafik, 129,680€ nga gjobat e gjykatave, dhe 6,934€, nga Agjencioni i Pyjeve, apo në total 1,481,406€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe i inkasojnë institucionet përkatëse, ndërsa Komunës i alokohen në baza tremujore gjatë vitit për realizim të pagesave.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	5,409,728	5,409,728	6,194,484	7,868,804	6,437,271
Të hyrat tatimore	3,228,367	3,228,367	2,142,214	3,618,562	2,783,469
Të hyrat jo tatimore	2,181,361	2,181,361	4,049,423	4,250,242	3,653,803
Të hyrat tjera	0	0	2,847		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të Komunës së Ferizajit ka rezultuar me 21 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Gjithashtu, raporti i auditimit të vitit 2023 ishte diskutuar në kuvendin komunal.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, 10 rekomandime janë zbatuar, 10 nuk janë zbatuar ende, dhe 1 rekomandim nuk është i zbatueshëm më, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës të mbajnë evidenca të sakta dhe të plota për detyrimet e papaguara dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të sigurohet se prezantimi i tyre në PVF është i saktë dhe i plotë.	Edhe këtë vit kemi prezantim jo të saktë të obligimeve të papaguara.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet kontingjente të prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.	Edhe këtë vit kemi prezantim jo të drejtë të detyrimeve kontingjente në PVF.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinim i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Keq klasifikime të shpenzimeve ka pasur edhe gjatë vitit 2024.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për llogaritë e arkëtueshme dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të sigurohet se prezantimi i tyre në PVF është i saktë dhe i plotë.	Llogaritë e arkëtueshme nuk janë prezantuar saktë në PVF edhe në vitin 2024.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e komunikimit mes departamenteve përkatëse me qëllim që të gjitha pasuritë e komunës të regjistrohen në regjistrin e pasurisë, në mënyrë që të ulët rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë.	Janë regjistruar pasuritë përkatëse dhe nuk ka rezultuar çështja e njëjtë këtë vit.	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha kontrollet e nevojshme funksionojnë gjatë tërë kohës, në mënyrë që para inicimit të procedurave të prokurimit të sigurohet se projektet kapitale janë të përfshira në ligjin e ndarjeve buxhetore ka fonde të mjaftueshme buxhetore të ndara me ligjin për ndarjet buxhetore për të gjitha kontrata e lidhura.	Janë ndërmarrë veprime për zbatim të rekomandimit.	I zbatuar
7.	Baza për konkluzion	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se janë zbatuar procedurat e prokurimit për të gjitha furnizimet dhe shërbimet të cilat janë objekt i prokurimit publik. Gjithashtu, Kryetari të sigurohet që për projektet e komunës të caktoj Menaxher Kontrate.	Janë ndërmarrë veprime për zbatim të rekomandimit.	I zbatuar
8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurohet që të respektohen kërkesat ligjore lidhur me përcaktimin e procedurave adekuate me rastin e financimit të Organizatave Jo-qeveritare, duke marrë për bazë kërkesat që dalin nga rregullorja 04/2017 për subvencionim të OJQ-ve.	Janë ndërmarrë veprime për zbatim të rekomandimit.	I zbatuar
9.	Të hyrat	Kryetari të sigurohet se kontrollet përkatëse në shqyrtimin e kërkesave të lejeve të ndërtimit janë funksionale gjatë gjithë kohës së operimit, dhe se para lëshimit të lejes së ndërtimit të sigurohet që janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore.	Janë ndërmarrë veprimet për zbatim të rekomandimit.	I zbatuar

10.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurohet, se planifikimet buxhetore për paga dhe shtesa t'i paraprijë një analizë e detajuar lidhur me nevojën e shtimit të numrit të paraleleve, rrjedhimisht e punonjësve në sektorin e arsimit me qëllim të parandalimit të hyrjes në obligime pa buxhet.	Për shkak të rritjes së numrit të nxënësve / paraleleve, ka qenë e nevojshme angazhimi i mësimdhënësve shtesë dhe si rezultat ky rekomandim nuk është i aplikueshëm.	Nuk është i aplikueshëm më
11.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha informatat për faturat e papaguara të dorëzohen me kohë tek Zyrtari Kryesor Financiar për të shmangur tejkalimin e afatit ligjor për ekzekutimin e pagesave. Kjo do të reduktojë rrezikun e padive nga operatorët ekonomikë dhe do të parandalojë shpenzime shtesë të interesit.	Obligimet nuk janë paguar brenda afatit kohor.	Nuk ka filluar zbatim
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestitim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuar me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.	Edhe këtë vit janë hasur pagesa nga fondi i projekteve tjera.	Nuk ka filluar zbatim
13.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese të bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	Janë ndërmarrë veprimet për zbatim të rekomandimit.	I zbatuar
14.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë kontrole dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit, paraprakisht të bëhet hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Janë ndërmarrë veprime për zbatim të rekomandimit.	I zbatuar
15.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se janë eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratave sipas kushteve të kontratës para inicimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale, ashtu që realizimi i kontratës të mos ketë pengesa dhe vonesa.	Edhe këtë vit janë hasur vonesa në realizim të kontratave.	Nuk ka filluar zbatim
16.	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë se para inicimit të procedurave të prokurimit, lënda e prokurimit/shërbimet publike nuk ofrohen nga një ndërmarrje publike.	Janë ndërmarrë veprimet për zbatim të rekomandimit.	I zbatuar

17.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Edhe këtë vit janë hasur mangësi në menaxhim të kontratave.	Nuk ka filluar zbatim
18.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që nuk autorizohet ndryshimi i kontratave përtej limiteve të lejuara nga ligji i prokurimi publik prej 10% të vlerës totale të kontratës.	Janë ndërmarrë veprimet për zbatim të rekomandimit.	I zbatuar
19.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurohet se bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë si dhe azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Kryetari duhet të analizoj nëse është e nevojshme hartimi i procedurave dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurisë së komunës.	Për shkak të rëndësisë dhe natyrës së kësaj çështje, rekomandimi është mbyllur.	I zbatuar
20.	Pasuritë	Kryetarit duhet të sigurohet që të funksionalizoj sistemin e-pasuria me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga ligjet në fuqi dhe sigurisë së informatave.	Sistemi e-Pasuria ende nuk është funksionalizuar.	Nuk ka filluar zbatim
21.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Edhe këtë vit janë hasur mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Ilir Abazi, Udhëheqës i ekipit



Edon Kabashi, Anëtar i ekipit



Albana Sahiti, Anëtare e ekipit



Ardian Bytyqi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Pagesa për investime kapitale nga buxheti i projekteve kapitale jo përkatëse	Është e mirëditur se Thesari ekzekuton pagesat nga buxheti komunal si pasojë e obligimeve, rrjedhimisht mjetet e marra nga Thesari në një projekt, kanë lënë pa pagesë projektin tjetër dhe në këtë kuadër kemi qenë të detyruar që të bëjmë pagesat për projektet në proces, duke shmangur paditë eventuale nga operatorët tjerë, përkatësisht procedurat ligjore përmbartimore që e shumëfishojnë dëmin buxhetor për komunën dhe debalancojnë përkajshëm skemën e menaxhimit të financave lokale. Mjetet buxhetore janë marrë kryesisht me vendime gjyqësore nga Ministria e Financave dhe aprovim të menaxherëve përkatës, gjë që veprimet në këtë drejtim ishin të natyrës së domosdoshme e të pamunduara për tu kundërshtuar apo tejkaluar. Kjo situatë e domosdoshmërisë, pa rrugëzgjidhje tjetër, arsyeton veprimet përkatëse.	Në raportin e auditimit, te kjo çështje, gjithashtu kemi theksuar se kjo kishte ndodhur për shkak se Ministria e Financave/Thesari ka shfrytëzuar buxhetin e projekteve përkatëse, për pagesat e shpenzimeve që kanë rezultuar nga vendimet gjyqësore për paditë e punonjësve të arsimit lidhur me kontratën kolektive. Në rastet kur krijohen rrethana të tilla dhe janë të domosdoshme të bëhen pagesa për realizimin e projekteve kapitale, të shihen mundësitë e rialokimit të buxhetit në kodin e projektit prej nga Thesari ka tërhequr mjetet buxhetore.



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Ferizajt, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem pjesërisht, ndërsa nuk pajtohem me Çështjen B6 (*për të cilën gjeni të bashkëngjitur komentet përkatëse*) derisa për gjetjet tjera dhe rekomandimet nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Agim Aliu

Kryetar i Komunës së Ferizajt

Data: 20.06.2025, Ferizaj



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁰ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹¹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ 1. Mbivlerësim i LL.A - Macropus Group Sh.p.k.; Nënvlërësim i LL.A - NNP Nderimi
- ⁶ Nga buxheti i projektit 51661 Rregullimi i kanalizimit fekal dhe rrugëve ne lagjen Mehaj, fshati Dremjak, janë paguar 50,000€ për projektin 49948 Rregullimi i kanalizimit fekal dhe i rrugëve ne lagjen Mehaj. Nga projekti 54757 Asfaltimi i rrugës UCK-së pranë kazermës së FSK, janë paguar 30,000€ për projektin 44149 Ndërtimi i shkollës së mesme në Ferizaj. Nga projekti 90509 Ndërtimi i kolektorit Nikadin Gërlicë, faza e I-rë, janë paguar 30,000€ për projektin 53723 Furnizimi dhe rikonstruimi i rrjetit te ndriçimit publik ne zona I, II, III dh IV dhe ne fshatrat Greme, Komogllavë, Dardani, Sojeve dhe Kosin. Nga projekti 49853 Ndërtimi i shkollës së re në Neredime, janë paguar 29,755€ për projektin 44149 Ndërtimi i shkollës se mesme në Ferizaj. Nga projekti 53014 Ndërtimi i palestrës për sporte luftarake në Ferizaj, janë paguar 27,905€ për projektin Zgjerimi dhe rregullimi i parkut Liria - lot 2 elektrika.
- ⁷ Subvencionimi i OJQ-ve - Fondacioni "Kosovarja Këndon"
- ⁸ Kontratat publike: Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë në vlerë 1,838,675€, Ndërtimi i shkollës së mesme në Komunën e Ferizajt në vlerë 1,803,726€, Ndërtimi i sillosëve për ruajtjen e grurit në vlerë 999,508€, Mirembajtja dhe rregullimi i rrugeve dhe trotuareve me asfaltë në vlerë 960,000€, Furnizimi dhe rikonstruimi i rrjetit te ndriçimit publik ne zonat I,II,III dhe IV, në vlerë 400,000€, Parqet e vogla Pocket Park në vlerë 208,586€, Blerja e dy autoambulancave per nevojat e QKMF-se në vlerë 147,998€.
- ⁹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹⁰ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹¹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.